

## **ELIRA HOXHA**

**Titulli:** Doktore Shkencash

**Fusha e ekspertizës kërkimore:** Financë, Kontabilitet, Audit

Elira Hoxha, Dr prej vitit 2008 është lektore e disa lëndëve të kontabilitetit në Universitetin "Marin Barleti". Ka përfunduar studimet e larta të ciklit të parë dhe të dytë pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë. Në dhjetor 2014 ka fituar Gradën shkencore “Doktor” nga Universiteti Publik “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Fakulteti i Biznesit. Është bashkëautore e dy teksteve universitare në fushën e kontabilitetit dhe autore e disa artikujve të publikuar në revista shkencore, brenda dhe jashtë vendit. Në vitin 2008, ka fituar titullin profesional “Auditues Ligjor”. Është bashkëpunëtore e ngushtë në disa projekte të Bankës Botërore me fokus përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar të korporatave. Ka një kontribut të cilësuar në grupet ndërinstitucionale të punës për procesin e transpozimit në legjislacionin shqiptar të Direktivës së kontabilitetit të BE.